

SHPALLJE E KONKURSIT TE BRENDSHËM PËR TITUJ AKADEMIK PËR STAF TË KOLEGJIT FAMA

Senati i Kolegjit FAMA, ne mbledhjen e mbajtur me 03.10.2018, mbështetur ne nenin 26 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe dispozitave te Statutit, vendosi për shpalljen konkursit te brendshëm për tituj akademik për staf të Kolegjit FAMA.

Kolegji FAMA, shpall konkurs për këto departamente:

- Departamenti Ekonomik,
- Departamenti Juridik,
- Departamenti e Shkencave Politike dhe Administratë Publike,
- Departamenti i Psikologjisë,
- Departamenti i Gjuhëve të huaja,
- Departamenti i Mirëqenies Sociale,
- Departamenti i Mjekësisë.

për këta tituj (gradë) akademik:

- Profesor Asistentë,
- Ligjërues, dhe
- Asistent.

Kriteret për avancim

Në thirrje për titujt/grada akademike mund të konkurroje personi që e ka të kryer arsimin e lartë të nivelit të studimeve Master dhe atë të doktoratës e që ka punime shkencore të botuara brenda dhe jashtë vendit, që ka aftësi për punë mësimore dhe përvojë pune në mësimdhënie.

Kushtet për zgjedhje Asistent

Në thirrje për titullin/gradën **Asistent** kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë gradën Master ose gradën ekuivalente me të ;
- Të ketë notën mesatare te studimeve baçelor dhe Master jo më pak se notën 8 (tetë) në secilën prej këtyre studimeve;
- Të zotërojë së paku njërën nga gjuhët e huaja (Anglisht, Gjermanisht dhe Frëngjisht)
- E preferuar është të ketë botime shkencore nga fusha përkatëse;
- Kohëzgjatja e thirrjes për titullin/gradën e **Asistentit** është për 3+3 vite;

Kushtet për zgjedhje Ligjërues

Në thirrjen për titullin/gradën **Ligjërues** kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë gradën Master ose gradën ekuivalente me të në fushën përkatëse në të cilën aplikon për zgjedhje, (përparësi do të ketë kandidati i cili ka të regjistruar doktoratën);
- Të ketë së paku dy botime shkencore;
- Të ketë afinitet pedagogjik;
- Të ketë së paku 3 (tre) vite përvojë pune në procesin mësimor të arsimit të lartë;
- Të ketë afinitete pedagogjike;
- Të njoh së paku njërën nga gjuhët e huaja (Anglisht, Gjermanisht dhe Frëngjisht)
- Kohëzgjatja e thirrjes për titullin/gradën e **Ligjëruesit** është për 3+3 vite,

Kushtet për zgjedhje Profesor Asistent

Në thirrje për titullin/gradën e **Profesorit Asistent** kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencës ose gradën ekuivalente me të;
- Të ketë të publikuar temën e doktoranturës.
- Të ketë të botuara së paku 3 botime shkencore,
- Të ketë së paku një punim kryesor të publikuar me recension në revista ndërkombëtare;
- Të ketë krijuar punime artistike ose të ketë pasur prezantime publike;
- Të ketë pjesëmarrje në aktivitete shkencore;
- Të ketë afinitet pedagogjik.
- Së paku të njoh njërën nga gjuhët e huaja (Anglisht, Gjermanisht dhe Frëngjisht)
- Kohëzgjatja e thirrjes për titullin/gradën e **Profesorit Asistent** është për 4+4 vite,